



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1388\_09\_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **21.10.2015**

**në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2016, nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZHET** ankesa e konsumatorit E. Z. me shifër DPE - 124225 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1388\_09\_15** i datës 28.09.2015.

**A r s y e t i m**

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.10.2015 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Enver Zeneli i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: 1. Për shkak se nuk janë marr parasysh shpenzimet e viteve paraprake me qëllim që të bëhet një analogji rreth shpenzimeve të energjisë elektrike; 2. Kundërshtimi tjetër ka të bëjë me vërejtjet rreth mos përgjigjes në afat të caktuar nga ndërmarrja e energjisë KEDS lidhur me ankesat e konsumatorit për verifikimin e njehsorit elektrik; dhe pika 3 e kundërshtimit ka të bëjë me konstatimet e bëra nga ekspertët e KEDS lidhur me njehsorin elektrik për të cilin është konstatuar se janë bërë gabime në matje deri në 1.42% me këtë njehsor.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se me datë 19.11.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 63393597 me gjendje TL=028167 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=050941 kWh (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 04670263 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Pas ndërrimit të njehsorit elektrik nga KEDS konsumatori i pakënaqur me shpenzimet e krijuara me këtë njehsor me datë 11.02.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë. Të njëjtën ankesë konsumatori e ka përsëritur edhe me datë 27.02.2014

Në bazë të ankesave të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 07.11.2014 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 04670263, ku TL=10415 kWh dhe TU=4262 kWh.



Gjithashtu me datë 07.11.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 04670263 me gjendje TL=010416 kWh dhe TU=004262 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 63833755 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh.

Pas ankesës së konsumatorit Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në arsyetimin se komisioni gjatë verifikimit nuk ka vërejtur asnjë parregullsi në njehsor element i cili mund të ketë shkaktuar ngarkesë financiare më shumë se sa njehsori i konsumatorit që ka regjistruar. Po ashtu është theksuar se faturimi për muajt nëntor dhe dhjetor 2012 dhe për muajin janar 2013 është konform Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike neni 21 dhe 23.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit Enver Zeneli dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë ka bërë gjithë analizat e nevojshme të rrjedhës së energjisë së shpenzuar nga konsumatori. Analiza e bërë ka përfshirë krahasimin e shpenzimeve për periudhat e njëjta kohore për tre njehsorët elektrik nr. 63393597, nr. 04670263 si dhe nr. 63833755 për periudhat 11/2011-09/2012, 11/2013-09/2014, si dhe 11/2014-09/2015 dhe me të drejt ka konstatuar se konsumatori nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike.

Nga analiza e bërë për këtë pikë matëse ka dalë se mesatarja e shpenzimeve mujore me njehsorin elektrik nr. 63393597 periudha 11/2011 - 09/2012 është **523 kWh/muaj**, me njehsorin elektrik nr. 04670263 periudha 11/2013 - 09/2014 është **621 kWh/muaj**, si dhe me njehsorin elektrik nr. 63833755 periudha 11/2014 - 09/2015 është **609 kWh/muaj**. Analiza po ashtu ka përfshirë edhe shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike të tre njehsorëve elektrike të cilët i ka pasur të montuar konsumatori, dhe nga analiza e shpenzimit vërehet se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike mes këtyre njehsorëve. Nga kjo ka dal se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit të parë nr. 63393597 prej periudhës 08/2002 – 11/2012 është **550 kWh/muaj**, mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit të parë nr. 04670263 prej periudhës 11/2012 – 11/2014 është **587 kWh/muaj** dhe mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit të parë nr. 63833755 prej periudhës 11/2014 – 09/2015 është **622 kWh/muaj**. Andaj lidhur me këtë Bordi ka konstatuar se konsumatori pa të drejt ka ngrit shqetësimin e tij në ankesë se DMK nuk ka marr për bazë analogjinë e shpenzimeve të bëra me herët që në realitet nga kjo që u paraqit më lartë vërtetohet se janë analizuar në detaje shpenzimet e energjisë për tre njehsorët elektrik.

Sa i përket pikës 2 të kontestimit se ndërmarrja e energjisë nuk ka shqyrtuar ankesat e konsumatorit në afat ligjor Bordi lidhur me këtë ka konstatuar se vonesat në zgjidhje të ankesave nuk e kanë dëmtuar konsumatorin në fazën gjatë shqyrtimit të tyre, gjithashtu është konstatuar se konsumatori ka mund të inicio procedurë të ankesës në ZRRE apo procedurë administrative në gjykatë për heshtje administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me pikën tjetër të kundërshtimit rreth matjes jo të saktë të njehsorit elektrik deri në 1.42% ku si rezultat i kësaj sipas konsumatorit i njëjti është dëmtuar. Bordi edhe për këtë pikë kontestuese ka analizuar në detaje shkresat e lëndës dhe vendimin e organit të shkallës së parë ku ka vërtetuar se DMK, ka dhënë saktë arsyetimet e saja se pavarësisht gabimeve të evidentuara nga ekipet e inspektimit prej 1.38% deri në 1.42% kjo nuk ka ndikuar në mos matjen e saktë të shpenzimeve mujore pasi që edhe gabimi i lejuar i pajisjeve matëse në këtë rast njehsorit elektrik sipas Kodit të matjes të OSSH-së është  $\pm 3\%$ . Për më tepër neni 5.11 paragrafi 5.11.1 të Kodit të matjes të OSSH-së



për gabimet në matje siç edhe u evidentuan edhe më lartë theksohet se kufiri i lejueshëm për këto raste mund të jetë deri në  $\pm 3\%$ .

Bordi ka konstatuar se organi I shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për këtë pikë matëse dhe janë vërtetuar saktësisht të dhënat e kilovatëve të marra në njehsorët elektrik me gjendjen e kilovatëve të evidentuara edhe në rrjedhën e energjisë elektrike, që nënkupton se çdo shpenzim i bërë nga ana e konsumatorit është regjistruar në mënyrë të drejtë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së:**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Krenar Bujupi, anëtar

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

#### **Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit E. G.,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.